



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.03.2022 miraton këtë:

### V E N D I M

#### Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/1666/22, i dt. 09.03.2022 dhe shpallet interes i përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë, në sipërfaqe prej 1000m<sup>2</sup> (njëmijë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22005m<sup>2</sup> (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) në vendin e quajtur Seishte-Seishte, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Pasuri Shtetërore e Kosovës K.K.Rahovec, shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve, Rahovec.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë “Caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit”, i cili do të shërbejë për aktivitete kulturore sportive për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjërë.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.293/22  
Datë:30.03.2022

